



FLETË INFORMUESE E PROJEKTIT

HARTËZIMI I BARRIERAVE NË BASENIN E LUMIT ERZEN

Identifikimi dhe prioritizimi i barrierave të përshtatshme për heqje në pellgun e Lumit Erzen

Financuar nga Open Rivers Programme (ORP) · Korrik 2026 – Gusht 2027

LIDER PROJEKTI

LUMI

PARTNERË ZBATUES

LUMI & AWP

BUXHETI

≈ 70.000 €



Harta e basenit Lumor Erzen

ZONA E PROJEKTIT

Projekti përfshin lumin Erzen dhe degët e tij, nga zona malore e Malit me Gropa deri në derdhjen në Gjirin e Lalëzit. Studimi mbulon rreth 278 km rrjet lumor, duke përfshirë rrjedhën kryesore dhe degët, ndër të cilat Zeza, Tërkuza dhe përroi i Petrelës. Zona e studimit përfshin një territor të gjerë të basenit lumor Erzeni dhe përfshin territorin e bashkive Tiranë, Vorë, Shijak, Durrës, Kavajë dhe Rrogozhinë.

OBJEKTIVAT KRYESORË

- 01 Identifikimi dhe hartëzimi i barrierave artificiale në lumin Erzen dhe degët e tij.
- 02 Vlerësimi i ndikimit të barrierave në lëvizjen e peshqve, transportin e sedimenteve dhe vazhdimësinë e lumit.
- 03 Vlerësimi i gjendjes ekologjike dhe hidromorfologjike për barrierat prioritare.
- 04 Analiza e statusit ligjor, pronësisë dhe mundësive reale për heqjen e barrierave.
- 05 Prioritizimi i barrierave sipas përfitimit ekologjik, realizueshmërisë teknike dhe ligjore dhe ndikimit hidromorfologjik.

AKTIVITETET KRYESORE

- 01 **Inventarizimi paraprak** – analizë e Planit të Menaxhimit të Basenit të Erzenit, imazheve satelitore, literaturës dhe të dhënave ekzistuese.
- 02 **Vrojtimet në terren** – inspektimi i barrierave përgjatë rrjedhës kryesore dhe degëve, duke regjistruar tipologjinë, dimensionet, funksionin, kalueshmërinë dhe ndikimin e tyre.
- 03 **Vlerësimi ekologjik dhe hidromorfologjik** – monitorimi i komuniteteve të peshqve dhe makroinvertebrorëve, karakterizimi hidromorfologjik dhe analiza e sedimenteve dhe ndryshimeve të shtratit të lumit.
- 04 **Analiza ligjore dhe e pronësisë** – verifikimi i pronësisë, lejeve të përdorimit të ujit dhe procedurave të nevojshme për heqjen e barrierave.
- 05 **Konsultimi me aktorët lokalë dhe institucionalë** – përfshirja e bashkive, institucioneve të ujit, operatorëve, pronarëve dhe komuniteteve lokale.
- 06 **Prioritizimi dhe raportimi** – prioritizimi dhe përzgjedhja e barrierave më të përshtatshëm për t'u hequr.

Ky projekt zbatohet nga LUMI, në bashkëpunim me Albanian Water Partnership, me mbështetjen financiare të Open Rivers Programme.